



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
-AUTORITETI I KONKURENCËS-**

NJOFTIM PARAPRAK PËRQËNDRIMI

Mbi përqendrimin nëpërmjet përfitimit të kontrollit indirekt të Tirana International Airport Sh.p.k nga Public Sector Pension Investment Board

Në datën 6 Qershor 2013, Autoriteti i Konkurrencës ka marrë njoftimin e transaksionit të realizuar në bazë të “Marrëveshjes për shitjen e aksioneve”, të nënshkruar ndërmjet palëve (“World Airport Partners GmbH & Co.KG” në cilësinë e **blerësit** dhe “Hochtief Aktiengesellschaft” në cilësinë e **shitësit** me objekt transferimin e 100% të aksioneve të “Hotchtief Airport GmbH” në cilësinë e shoqërisë **target**) më datë 7 Maj 2013, me pasojë përfundimin e kontrollit indirekt të Tirana International Airport Sh.p.k nëpërmjet përfitimit të 47% të kuotave të kësaj të fundit.

Veprimtaria e palëve pjesëmarrëse në përqendrim është si vijon:

- **Tirana International Airport Sh.p.k (TIA)**: përfshin në fushën e veprimtarisë , projektimin, financimin, ndërtimin, vënien në punë, mirëmbajtjen, kryerjen, administrimin dhe zhvillimin e Aeroportit TIA;
- **World Airport Partners GmbH & Co.KG**: është një shoqëri bashkëpunimi gjermane e cila funksionon si mekanizëm investimi *ad hoc* për llogari të shoqërisë mëmë Public Sector Pension;
- **Hochtief Aktiengesellschaft**: është një shoqëri gjermane dhe aksionere e 100% të kapitalit themetar të shoqërisë Target;
- **Hotchtief Airport GmbH**: është një shoqëri investitore dhe dministratore private industriale aeroportesh, shoqëria ka një portofol me pjesëmarrje në aeroportet e Athinës, Budapestit, Deyseldorf, Hamburgut, Sidnei dhe Tiranës;

Nga shqyrtimi i dokumentacionit, rezulton se transaksioni i njoftuar është në përputhje me nenin 10, pika 1, shkronja b dhe 12, pika 1 të Ligjit nr. 9121 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar.

Autoriteti fton palët e interesuara të shprehin opinionet e tyre për transaksionin e njoftuar jo më vonë se 15 ditë nga publikimi i këtij njoftimi.

Opinionet mund të dërgohen pranë Autoritetit të Konkurrencës me fax (nr 0355 4 2234 497), me postë në adresën: Autoriteti i Konkurrencës, Rr “Sami Frashëri”, Nr 4, Kati IV Tiranë; apo me e-mail në adresën competition@caa.gov.al